

EDITORIALI

FSK-ja

Nëse ka një institucion që po e ruan stabilitetin e vet dhe po na e zbardh faqen, pa dyshim kjo është Forca e Sigurisë së Kosovës. FSK-ja është ndër organizatat e pakta që ka mbetur larg skandaleve. Pothuaj të gjitha segmentet e shtetit tonë janë prekur nga keqpërdorime të ndryshme, abuzime financiare, shkelje ligjore, punësime nepotike, korrupsion. Nuk ka mbetur sektor pa u degraduar, sidomos këto dy vitet e fundit. Shihni ç'ndodh nëpër ministri, komuna, gjykata, spitale, shkolla, universitete, kompani publike...Lista është e mbushur me ngjarje të shëmtuara, që reflektojnë mungesë qëndrueshmërie, paaftësi menaxhuese, shpërdorim të besimit të publikut, jotransparençë dhe dështim të sundimit të ligjit. Për fat të mirë, FSK-ja ka arritur t'i mbijetojë këtij peizazhi skandaloz, ndoshta edhe për shkak të natyrës ushtarake të saj, disiplinës, karakterit të fortë të pjesëtarëve dhe një idealizmi që vërehet te ata që i janë bashkuar kësaj Forcë. Njoffimet e konfirmuara nga Qeveria se së shpejti Forca e Sigurisë së Kosovës do të shndërrohet në Forcën e Armatosura të Kosovës, është i shumëpritur, si një element i rëndësishëm i konsolidimit të shtetësisë. Një shtet pa ushtri nuk është i plotë. Falë edhe një partneriteti të ngushtë me misionin e NATO-s në vendin tonë, FSK-ja i ka përmbushur kapacitetet operationale qysh vitin e kaluar. Ndërkohë, edhe afati pesëvjeçar i përcaktuar në Pakon Ahtisari ka kaluar duke hapur rrugë transformimit final të organizatës. Krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës mund të ndikojë pozitivisht në stabilitetin dhe rritjen e sigurisë së vendit, kurse interesimi edhe nga radihet e pakicave kosovare për të qenë pjesë e ushtrisë së re është inkurajues. Institucionet e tjera është mirë të nxjerrin mësim dhe ta marrin si model FSK-në e jo të zhyten në afera korruptive dhe keqmenaxhim të skajshëm, siç është duke ndodhur prej kohësh.

22.02.2014

KOSOVA SOT

DYSHOHET PËR MARR

Rënie d
TË INTE
Kritikohet edhe l

BANORËT E 'SOFALISË', PET

Pazaret komunal
dhe tri lagje të
Kërkohet përfundimi, p
i revidimit të katër plan

"Drejtori i Urbanistikës, Liburr bllokadë nga Ministria e Mjeda ne jemi ankuar në Ministri dhe planit mund të vijojë në bazë vitin e kaluar, 2013. Ky drejtor qytetarë për të gjitha shkeljet po e shfrytëzojmë një të drejtë peticionit të qytetarëve", thotë